

Statistikat e krimeve

Tremujori i katërt 2018

Tiranë, më 31 Janar 2019: Në tremujorin e katërt 2018, janë evidentuar gjithsej 8.485 vepra penale, duke shënuar një rritje me 0,1 %, krahasuar me tremujorin e katërt 2017. Në vitin 2018, janë evidentuar gjithsej 34.468 vepra penale, 0,4 % më shumë, krahasuar me vitin 2017.

Numri i grupveprës vrasje me dashje të evidentuar, në tremujorin e katërt 2018, është 12, dy vrasje më shumë, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Në vitin 2018, janë evidentuar 51 vrasje me dashje, një vrasje më shumë, krahasuar me vitin 2017.

Për grupveprën penale vrasje mbetur në tentativë, në këtë periudhë janë evidentuar 25 vepra, 3 më shumë, krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2017. Numri i vrasjeve mbetur në tentativë, në vitin 2018, është 114 vepra, me një rënie me 11,6 %, krahasuar me vitin 2017.

Numri i veprave penale të rënda kundër pasurisë, në këtë tremujor është 26, duke shënuar një rënie me 16 vepra, krahasuar me tremujorin e katërt 2017. Kjo grupvepër përfshin veprat penale vjedhje me dhunë, vjedhje me armë dhe vjedhje me pasojë vdekjen. Për këtë kategori, në vitin 2018, janë evidentuar 111 vepra, me një rënie me 32,3 %, krahasuar me vitin 2017.

Në tremujorin e katërt 2018, janë evidentuar 28 krime me natyrë seksuale, 7 më shumë, krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2017. Për grupveprën penale krime seksuale, në vitin 2018, janë evidentuar 110 vepra, 3 më pak, krahasuar me vitin 2017.

Numri i veprave penale në fushën e drogës, në tremujorin e katërt 2018, është 462 vepra, duke shënuar një rritje me 1,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2017. Këtu përfshihen veprat prodhimi dhe shitja e narkotikëve, kultivimi i bimëve narkotike dhe trafikimi i narkotikëve. Në vitin 2018, janë evidentuar 1.972 vepra penale në fushën e drogës, me një rënie me 7,0 %, krahasuar me vitin 2017.

Në këtë periudhë janë evidentuar 66 vjedhje të automjeteve, dy më pak, krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2017. Për të njëjtën vepër, në vitin 2018, janë evidentuar 252 vepra, duke shënuar një rënie me 23,4 %, krahasuar me vitin 2017.

Për publikim 31/01/2019

Numri i veprave penale të evidentuara për vjedhje lokale tregtie, në tremujorin e katërt 2018, është 149, duke shënuar një rritje me 12,0 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Në vitin 2018, janë evidentuar 596 vjedhje, me një rritje me 21,1 %, krahasuar me vitin 2017.

Numri i veprave penale të evidentuara për vjedhje banese, në tremujorin e katërt 2018, është 285, duke shënuar një rënie me 5,0 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Ndërkohë në vitin 2018, janë evidentuar 1.218 vjedhje banese, me një rritje me 6,4 %, krahasuar me vitin 2017.

Në këtë periudhë janë evidentuar 15 vjedhje duke shpërdoruar detyrën, 15 vjedhje më pak, krahasuar me të njëjtin tremujor të 2017. Në vitin 2018, janë evidentuar 70 vepra, duke shënuar një rënie me 40,7 %, krahasuar me vitin 2017.

Numri i veprave penale të evidentuara për vjedhje mbetur në tentativë, në tremujorin e katërt 2018, është 99, gjashtë vepra më shumë, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Në vitin 2018, janë evidentuar 383 vepra, duke shënuar një rënie me 7,3 %, krahasuar me vitin 2017.

Në tremujorin e katërt 2018, janë evidentuar 564 shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor, duke shënuar një rënie me 5,7 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Numri i veprës penale shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor, në vitin 2018 është 2.164, me një rënie me 3,7 %, krahasuar me vitin 2017.

Tab. 1 Vepra penale të evidentuara

Vepra penale	2017	2018	Ndryshimi vjetor në %	T4 - 2017	T4 - 2018	Ndryshimi tremujor në %
Vrasje me dashje	50	51	2,0	10	12	20,0
Vrasje mbetur në tentativë	129	114	-11,6	22	25	13,6
Vepra penale të rënda kundër pasurisë	164	111	-32,3	42	26	-38,1
Krime seksuale	113	110	-2,7	21	28	33,3
Krime në fushën e drogës	2.120	1.972	-7,0	454	462	1,8
Vjedhje automjete	329	252	-23,4	68	66	-2,9
Vjedhje lokale tregtie	492	596	21,1	133	149	12,0
Vjedhje banese	1.145	1.218	6,4	300	285	-5,0
Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën	118	70	-40,7	30	15	-50,0
Vjedhje mbetur në tentativë	413	383	-7,3	93	99	6,5
Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor	2.247	2.164	-3,7	598	564	-5,7
Vepra penale të tjera	26.997	27.427	1,6	6.707	6.754	0,7
Gjithsej	34.317	34.468	0,4	8.478	8.485	0,1

Autorët e veprave penale

Në tremujorin e katërt 2018, janë evidentuar gjithsej 9.301 autorë të veprave penale, duke shënuar një rritje me 20,2 % krahasuar me tremujorin e katërt 2017. Numri gjithsej i autorëve të veprave penale, në vitin 2018 është 34.537, me një rritje 7,0 %, krahasuar me vitin 2017.

Numri i autorëve për grupveprën vrasje me dashje, në këtë tremujor është 15, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë janë 5 autorë më shumë të evidentuar. Në vitin 2018, janë evidentuar 60 autorë për vrasje me dashje, duke shënuar një rritje me 25,0 %, krahasuar me vitin 2017.

Në tremujorin e katërt 2018, numërohen 26 autorë të evidentuar për grupveprën vrasje mbetur në tentativë, 2 autorë më shumë, krahasuar me tremujorin e katërt 2017. Numri i autorëve për vrasje mbetur në tentativë, në vitin 2018 është 149, duke shënuar një rënie me 4,5 %, krahasuar me vitin 2017.

Numri i autorëve për vepra penale të rënda kundër pasurisë, në tremujorin e katërt 2018, është 30 autorë, 12 autorë më pak, krahasuar me tremujorin e katërt të vitit 2017. Ndërkohë në vitin 2018, janë evidentuar 131 autorë, duke shënuar një rënie me 31,8 %, krahasuar me vitin 2017.

Në këtë periudhë janë evidentuar 31 autorë për grupveprën krime me natyrë seksuale, 7 autorë më shumë, krahasuar me tremujorin e katërt të vitit të kaluar. Në vitin 2018, janë evidentuar 114 autorë për krime seksuale, 3 autorë më shumë, krahasuar me vitin 2017.

Numri i autorëve për krime në fushën e drogës, në tremujorin e katërt 2018, është 612, duke shënuar një rritje me 6,6 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Ndërkohë në vitin 2018, numri i autorëve është 2.435 autorë, duke shënuar një rënie me 4,2 %, krahasuar me vitin 2017.

Për veprën vjedhje e automjeteve, në këtë tremujor janë evidentuar 23 autorë, e njëjta vlerë edhe për tremujorin e katërt të vitit të kaluar. Në vitin 2018, janë evidentuar 68 autorë, me një rënie me 56,7 %, krahasuar me vitin 2017.

Numri i autorëve për vjedhje banese, në tremujorin e katërt 2018 është 196, duke shënuar një rritje me 62,0 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Ndërkohë në vitin 2018, janë evidentuar 742 autorë për vjedhje banese, me një rritje me 18,2 %, krahasuar me vitin 2017.

Për veprën vjedhje e kryer duke shpërdoruar detyrën, në këtë tremujor janë evidentuar 16 autorë, 13 autorë më pak, krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2017. Në vitin 2018, janë evidentuar 77 autorë, duke shënuar një rënie me 40,8 %, krahasuar me vitin 2017.

Në tremujorin e katërt 2018, janë evidentuar 93 autorë për grupveprën vjedhje mbetur në tentativë, duke shënuar një rritje me 50,0 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Numri i autorëve për vjedhje mbetur në tentativë, në vitin 2018 është 330, duke shënuar një rritje më 7,1 %, krahasuar me vitin 2017.

Numri i autorëve për veprën shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor, në tremujorin e katërt 2018, është 538, duke shënuar një rënie me 7,4 %, krahasuar me të njëjtin tremujor të një viti më parë. Në vitin 2018, numërohen 2.101 autorë, 5,0 % më pak, krahasuar me vitin 2017.

Tab. 2 Autorë të veprave penale

Vepra penale	2017	2018	Ndryshimi vjetor në %	T4 - 2017	T4 - 2018	Ndryshimi tremujor në %
Vrasje me dashje	48	60	25,0	10	15	50,0
Vrasje mbetur në tentativë	156	149	-4,5	24	26	8,3
Vepra penale të rënda kundër pasurisë	192	131	-31,8	42	30	-28,6
Krime seksuale	111	114	2,7	24	31	29,2
Krime në fushën e drogës	2.541	2435	-4,2	574	612	6,6
Vjedhje automjete	157	68	-56,7	23	23	0,0
Vjedhje lokale tregtie	381	587	54,1	70	190	171,4
Vjedhje banese	628	742	18,2	121	196	62,0
Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën	130	77	-40,8	29	16	-44,8
Vjedhje mbetur në tentativë	308	330	7,1	62	93	50,0
Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor	2.212	2.101	-5,0	581	538	-7,4
Vepra penale të tjera	25.420	27.743	9,1	6.179	7.531	21,9
Gjithsej	32.284	34.537	7,0	7.739	9.301	20,2

Metodologjia

Statistikat e krimeve pasqyrojnë të dhëna mbi veprat penale të evidentuara dhe personat e dyshuar si autorë në kryerjen e një vepre penale sipas Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Të dhënat mbi autorët bazohen në persona të dyshuar në kryerjen e një vepre penale, jo në gjykime përfundimtare, të cilat janë në kompetencat e organeve të drejtësisë për të dhënë vendimin.

Përkufizime

Vepra penale: Veprat me të cilat çënohen, dëmtohen vlerat juridike të njeriut dhe të bashkësisë së caktuar quhen vepra penale apo me një term të përgjithshëm, kriminalitet. Ato ndahen në krime dhe kundërvajtje penale.

Autorë: Persona të cilët me veprimin ose mosveprimin e tyre lejojnë që të ndodhë një vepër penale, pra shkaktojnë pasojën e veprës penale. Autorët mbi 14 vjeç kanë përgjegjësi penale, ndërkohë fëmijët nën 14 vjeç janë të përjashtuar nga përgjegjësia penale.

Vrasje me dashje: Përfshin të gjitha ato vepra penale kundër jetës, të kryera me dashje si vrasje me dashje, vrasje me dashje në lidhje me një krim tjetër, vrasje me paramendim, vrasje për gjakmarrje, vrasje në rethana tjera cilësuese, vrasja e funksionarëve publikë, vrasja e punonjësve të policisë së shtetit, vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare dhe vrasje e foshnjës.

Vepra penale të rënda kundër pasurisë: Përfshihen ato vepra që synojnë vjedhjen e një personi, duke përdorur dhunë apo forcë si vjedhje me dhunë, vjedhje me armë dhe vjedhje me pasojë vdekjen.

Krime seksuale: Përfshihen ato vepra të kundërligjshme që ndikojnë në sferën e sigurisë së lirisë seksuale dhe të zhvillimit normal të formimit seksual, si marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur, marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me dhunë me të mitur të moshës 14-18 vjeç, marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura, marrëdhëniet homoseksuale me dhunë me të rritur, marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona të pazotë për t'u mbrojtur, marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me kërcënim me përdorimin e armës, marrëdhënie seksuale ose homoseksuale duke shpërdoruar detyrën, marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona në gjini ose nën kujdestari, marrëdhënie seksuale ose homoseksuale në vende publike, dhuna seksuale, vepra të turpshme dhe ngacmimi seksual.

Vjedhje mbetur në tentativë: Përshihen vepra si vjedhje banke mbetur në tentativë, vjedhje me armë në tentativë, vjedhje me dhunë në tentativë, vjedhje të tjera në tentativë.

Krime në fushën e drogës: Përshihen vepra si prodhimi dhe shitja e narkotikëve, kultivimi i bimëve narkotike, trafiku i narkotikëve.

Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor i referohet nenit 290 të Kodit Penal.

Burimi i të dhënave:

Të dhënat janë siguruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

Të dhënat mbi veprat penale të evidentuara dhe autorët janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë referohu: <http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/cilësia-statistikore.aspx/> Politika e revizionimit statistikor.